

SYLLABUS

Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
Titulli i lëndës:	Teoria dhe Praktika e menaxhimit të ndërmarrjeve
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	5
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Afrim Loku
Detajet kontaktuese:	afrim.loku@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me mënyrën e menaxhimit, kulturën organizative dhe mjedisin.</p> <p>Hyrje në Menaxhment. menaxhimit me kalimin e kohës. kultura organizative dhe mjedisi, menaxhimi global mjedisor. përgjegjësia sociale dhe etika menaxheriale. Marrja e vendimeve dhe planifikimin. Teknikat e planifikimit. Struktura organizative dhe hartimi i saj. Procesi i vendimmarrjes marrja. Komunikimi ne BVM dhe IT. Lidërshipi (Udhëheqja) dhe Menaxhimi i ndryshimeve ne inovacion dhe në ndërmarrësi.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me konceptet bashkëkohore të teorisë së menaxhimit në inovacion dhe ndërmarrësi dhe aftësitë e tyre për zbatimin në praktikë tek bizneset, kompanitë dhe organizatat e tjera.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti do të të përfitojë që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njoh konceptet teorike mbi menaxhimin e sistemit dhe menaxhimin në mjedisin të ndërmarrjeve dhe inovacionit me theks të veçantë fushën e ndërlidhur me planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin. • Kuptoj rolin kritik të menaxhimit në ndërmarrësi dhe inovacion dhe zbatimin e saj në BVM • Krijoj, ide analitike dhe kreative dhe të zhvilloj qasje të menaxhimit bashkëkohor për të ndërtuar një organizatë të mirëqenë dhe të suksesshme • Vlerësoj praktikatat e menaxhimit në ndërmarrje dhe ti avancoj në fushën e menaxhimit bash kohorë për një treg konkurrues

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet - detyra			
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Punim seminarik (hulumtim)	1	15	15
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare në provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Punimi, projektet, prezantim i punimit, etj	1	5	10
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi në shtjellimin e materialit duke marrë raste studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi në gupe nga studentet dhe luajtja e roleve, mësimet praktike për lëndën dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohurit e fituara gjatë ligjërates. Ligjëratat sqarojnë dhe diskutojnë konceptet kyçe dhe interaktivitetet. Studenteve u sugjerohet që të lexojnë paraprakisht temat për të cilat zhvillohen ligjëratat. Studentet duhet të lexojnë tekstin baze dhe artikujt elektronik për tu përgatitur për ligjërata Gjatë ushtrimeve – bëhet prezantimi i rasteve, sqarimi i koncepteve teorike, diskutime, prezantim i punimeve të studentëve.		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	60 pikë – nga provimi final i cili do të jetë i organizuar me pyetje të hapura analitike dhe logjike me zgjedhjen e opsioneve dhe ideve kreative. 10 pike – Angazhimi në ligjërata dhe diskutime po ashtu edhe vijueshmëria. 30 pikë – Punimi i studentit i elaboruar në formë profesionale me raste të veçante të studimit me karakter shkencor dhe hulumtues		
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori dhe pajisjeve tjera të nevojshme etj.		

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% Teori 40% Angazhim ne diskutime, punë praktike, raste studimi me karakter shkencor dhe hulumtues
Literatura	
Literatura bazë	1. Bazat e Menaxhimit Prof. Dr Berim Ramosaj, Prishtine 2013
Literatura shtesë	1. Roobins & DeCenzo, Bazat e Menaxhimit, UET, Tiranë, përkthim në gjuhën shqipe. 2. Management: Stephen Robins & Mary Coulter, Prentince Hall, 2007 or later seditions 3. Bazat e Menaxhimit: Stephen P !o""in Universiteti Shtete'ror i San Diegos 4. "Management" Hicks and Gullet, McGraw-Hil – New York
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Javët	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Hyrje në teorinë dhe praktikat e menaxhimit,
Java e dytë	Konceptet kryesore dhe aplikimi në biznes, menaxhimet me kalimin e kohës
Java e tretë	Kultura organizative dhe mjedisi i biznesit në turizëm
Java e katërt	Menaxhimi i bizneseve turistike
Java e pestë	Përgjegjësia sociale dhe etika menaxheriale
Java e gjashtë	Marrja e vendimeve dhe planifikimi
Java e shtatë	Menaxhimi planeve strategjike dhe teknikat
Java e tetë	Struktura organizative dhe hartimi i saj ne bizneset turistike
Java e nëntë	Inovacione, komunikimi dhe IT
Java e dhjetë	Lidershipi dhe besimi
Java e njëmbëdhjetë	Menaxhimi i ndryshimeve
Java e dymbëdhjetë	Menaxhimi i RNJ në bizneset turistike
Java e trembëdhjetë	Kontrolli si funksion i menaxhmentit dhe aplikimit ne turizëm
Java e katërmëdhjetë	Prezantimi i punës së studenteve me karakter shkencor dhe hulumtues
Java e pesëmbëdhjetë	Prezantimi i punës së studenteve me karakter shkencor dhe hulumtues
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	